

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI**  
**Tiranë, 24.05.2019**  
**NJOFTIM PËR MEDIAN**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), me pjesëmarrjen e anëtarëve të tij dhe anëtarëve zëvendësues, të Avokatit të Popullit, të përfaqësuesve nga subjektet e ftuara sipas pikës 2 të nenit 233 të ligjit nr. 115/2016, ditën e sotme 24.05.2019, zhvilloi mbledhjen e radhës me këtë rend dite:

1. Shqyrtimi i rasteve të kandidatëve të tërhequr nga kandidimi, për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese.

2. Shqyrtimi i rasteve për gjetjet e deritanishme, në procedurën e verifikimit të disa prej kandidatëve për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese.

Këshillimi i Emërimeve në Drejtësi, pasi shqyrtoi procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturës dhe aktet përkatëse për shprehjen e vullnetit për tërheqje nga kandidimi dhe për ndalimin për kandidim mbi bazën e korrespondencës me ILDKPI për mos dorëzimin në afat të deklaratve të pasurisë sipas ligjit (brenda 15 ditëve), ka vendosur Përfundimin e Procedurës së Verifikimit, Vlerësimit, Pikëzimit dhe Renditjes së Kandidaturës për 2 kandidatë dhe ndalimin e kandidimit për 4 kandidatë të tjerë, në vendet vakante ekzistuese.

Lista e kandidatëve të tërhequr nga kandidimi:

1. Theodhori Sollaku
2. Avni Shehu

Lista e kandidatëve të ndaluar nga kandidimi është si më poshtë:

1. Ardita Alsula
2. Denar Biba
3. Kristaq Traja
4. Kostandin Kazanxhi

Vendimet për përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës, si edhe aktet përkatëse të kandidatëve për tërheqje dhe vendimet për ndalim nga kandidimi, do të publikohen të arsyetuara në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.